



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë-Albania,

Tel/Fax 04 22268141 ; 22268142

Nr. 532/10 Prot.

Tiranë, më 10.09.2015

V E N D I M

Nr. 90, datë 10.09.2015

“Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 23, datë 12.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”

Bazuar në nenet 11, 14 dhe 15, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenet 121 e vijues, të Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VËREJ:

Me kërkesat Nr. 532/5 Prot., datë 07.08.2015, Nr. 532/6 Prot., datë 07.08.2015, Nr. 532/7 Prot., datë 14.08.2015 dhe Nr. 532/8 Prot., datë 14.08.2015, “Ankim Administrativ”, drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, disa punonjës të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ***** , ***** , ***** dhe ***** kanë kërkuar: “Ndryshimin e aktit administrativ: Vendimit Nr. 83, datë 31.07.2015, “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 23, datë 12.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, duke u vendosur edhe pjesa që bën fjalë për statusin e tyre të punësimit.

Me Vendimin nr. 23, datë 12.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është vendosur:

1. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklaramit të statusit të nëpunësit civil për punonjësen e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ***** dhe të kryejë të gjitha veprimete nevojshme administrative për të revokuar deklaramin e statusit si “nëpunës civil” për këtë punonjëse.

Pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Dixhitalizimit, në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar*” ta shpallë vend të lirë pune, për t’u plotësuar nëpërmjet procedurës së konkurimit.

2. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklarimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për të revokuar aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit civil të nivelit të ulët drejtues për punonjësin ***** si “*Përgjegjës në sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*” dhe të deklarojë statusin e tij për pozicionin që ka mbajtur në momentin e fillimit të efekteve të ligjit si “*specialist në Sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë, në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*”.
3. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklarimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për të revokuar aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit civil në periudhë prove për pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit*” dhe të bëjë deklarimin e statusit në pozicionin “*Specialist në sektorin e Laboratorit të vetive fiziko-mekanike*”, ku ka qenë i punësuar ditën e fillimit të efekteve të ligjit.

Pozicioni *Përgjegjës i Sektorit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit* të shpallet vend të lirë për t’u plotësuar nëpërmjet procedurës së konkurimit.

4. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklarimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për të revokuar deklarimin e statusit si “nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin e *Përgjegjësit të Sektorit të Arkivit Qendror* dhe t’i njihet statusi i nëpunësit civil për atë pozicion që mbante në datën 26.02.2014, “*Specialist në Sektorin e Hapësirës Bregdetare*”.

Pozicioni i punës “*Përgjegjës i Sektorit të Arkivit Qendror*” të SHGJSH duhet të shpallet i lirë dhe punonjësi ***** duhet të sistemohet në një pozicion tjetër të përshtatshëm me nivelin e statusit të specialistit ose të marrë pjesë në plotësimin e pozicionit të “*Përgjegjësit të Sektorit të Arkivit Qendror*”, nëpërmjet procedurës së konkurimit për ngritjen në detyrë.

Departamenti i Administratës Publike me shkresat Nr. Prot. 3917/1, datë 19.08.2015, “*Mbi ankimin administrativ të ushtruar nga ******” dhe Nr. Prot. 3918/1, datë 02.09.2015, “*Mbi ankimin administrativ të ushtruar nga ******”, ka kërkuar rivlerësimin e qëndrimit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në lidhje me këto raste.

Kërkuesit ***** , ***** , ***** dhe ***** në parashtrimet e tyre, pretendojnë se:

1. Argumentat e paraqitura në pjesën arsyetuese të Vendimit Nr. 83, datë 31.07.2015, se për periudhën kohore ndërmjet aktit të emërimit dhe fillimit të efekteve financiare, punonjësit kanë qenë në punë, por nuk janë paguar për shkak se kjo periudhë ka shërbyer për realizimin e procesit të dorëzimit dhe marrjes së detyrës në përputhje me pikën 51 të Kreut VII të VKM Nr. 171, datë 26.03.2014, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*, qëndrojnë dhe janë plotësisht të vlefshme ligjërisht dhe në rastin e tyre.

2. Punonjësjë ***** pretendon se pavarësisht që paga në pozicionin e Specialistit në Sektorin e Dixhitalizimit ka filluar në datën 01.04.2014, detyrën e ka marrë në datën 24.02.2014; se kohëzgjatja e marrjes së detyrës në dorëzim nga data 24.02.2014 deri më 31.03.2014, në rastin e saj është tërësisht e justifikueshme për shkak të veçorive të detyrës individuale, e cila ka të bëjë me specifikat e teknologjisë së gjeoinformacionit për njëhsimin dhe përvehtësimin e hartografisë me veçoritë e punimeve gjeologjike. Bazuar në këto arsye, punonjësjë ***** kërkon aplikimin e standardeve të njëjta të drejtësisë, duke u ndryshuar vendimi i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe duke u vendosur:
 - “1. Të revokoj pikën 3 të Vendimit nr. 23, datë 12.03.2015.
 2. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë, për punonjësen e Sh.Gj.Sh-së ***** , anulimin e aktit Nr. 1035/3 Prot., datë 07.07.2015 dhe deklarimin e statusit të nëpunësit civil në periudhë prove në pozicionin: Specialiste në Sektorin e Dixhitalizimit, Drejtoria e Gjeoinformatizimit të SH.GJ.SH-së”.

3. Punonjësi ***** pretendon se, në bazë të protokollit të Drejtorisë së Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë, si dhe të vërtetimit përkatës të Drejtorit të saj, ***** , e ka marrë detyrën më 25.02.2014 dhe jo më 06.03.2014. Ky punonjës kërkon aplikimin e standardeve të njëjta të drejtësisë, duke u ndryshuar vendimi i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe duke u vendosur:
 - “1. Të revokoj pikën 6 të Vendimit nr. 23, datë 12.03.2015.
 2. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë, për punonjësin e Sh.Gj.Sh-së ***** , anulimin e aktit Nr. 1035/1 Prot., datë 07.07.2015 dhe deklarimin e statusit të nëpunësit civil në periudhë prove në pozicionin: Përgjegjës i Sektorit të Dinamikës Detare në përputhje me aktet nr. 1353/3, datë 30.06.2014 të DAP-it dhe Nr. 621, datë 10.04.2014, Nr. 939/11, datë 07.07.2014, nr. 1057, datë 14.07.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të SH.GJ.SH-së”.

4. Punonjësi ***** pretendon se është emëruar në detyrën Përgjegjës Sektori nga detyra specialist me të njëjtin akt të Drejtorit të Përgjithshëm të SH.GJ.SH.-së, nr. 228, datë 24.02.2014, që janë emëruar edhe punonjësit e cituar në pikat 1, 2 dhe 3 të vendimit nr. 83, datë 31.07.2015. Ai thekson se ka 5 vjet vjetërsi pune në SH.GJ.SH. dhe është me diplomë Gjeoinformatike. Për këto arsye, ky punonjës kërkon aplikimin e standardeve të njëjta të drejtësisë, duke u ndryshuar vendimi i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe duke u vendosur:
 - “1. Të revokoj pikën 4 të Vendimit nr. 23, datë 12.03.2015.

2. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë, për punonjësen e Sh.Gj.Sh-së ***** , anulimin e aktit Nr. 1035/12 Prot., datë 07.07.2015 dhe deklarimin e statusit të nëpunësit civil në periudhë prove në pozicionin: Përgjegjës i Sektorit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, në përputhje me aktet nr. 1191/86, datë 14.08.2014 të DAP-it.”.

5. Punonjësi ***** pretendon se kohëzgjatja e marrjes së detyrës në dorëzim nga data 24.02.2014 deri më 01.04.2014 ka ndodhur për shkak të volumit të madh të dokumentacionit që përmbajnë dosjet të arkivit, vërtetuar kjo edhe nga procesverbali i datës 09.04.2014, mbi dorëzimin e dokumentacionit gjeologjik që ndodhet në Arkivin Qendror të SH.GJ.SH-së. Në mbështetje të këtij pretendimi, kërkuesi i referohet ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, për arkivat. Bazuar në sa më sipër, ky punonjës kërkon aplikimin e standardeve të njëjta të drejtësisë, duke u ndryshuar vendimi i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe duke u vendosur:

“1. Të revokoj pikën 1 të Vendimit nr. 23, datë 12.03.2015.

2. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë, për punonjësen e Sh.Gj.Sh-së ***** , anulimin e aktit Nr.1035/2 Prot., datë 07.07.2015 dhe deklarimin e statusit të nëpunësit civil në periudhë prove në pozicionin: Përgjegjës në Sektorin e Arkivit Qendror Teknik të Gjeologjisë, në Drejtorinë e Programim-Zhvillimit, në përputhje me aktet nr. 1191/86, datë 14.08.2014 të DAP-it.”.

Pas rishqyrtimit të dokumentacionit të administruar në dosjen e inspektimit të përgjithshëm, në lidhje me gjendjen e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, në institucionin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe vlerësimit të kërkesave Nr. 532/5 Prot., datë 07.08.2015, Nr. 532/6 Prot., datë 07.08.2015, Nr. 532/7 Prot., datë 14.08.2015 dhe Nr. 532/8 Prot., datë 14.08.2015, “Ankim Administrativ”, respektivisht të punonjësve ***** , ***** , *** ***** dhe ***** , si dhe shkresave Nr. Prot. 3917/1, datë 19.08.2015, “Mbi ankimin administrativ të ushtruar nga ***** ” dhe Nr. Prot. 3918/1, datë 02.09.2015, “Mbi ankimin administrativ të ushtruar nga ***** ”, të Departamentit të Administratës Publike, u konstatua sa më poshtë:

1. Punonjësi ***** , që prej vitit 2008, ka qenë i punësuar në pozicionin “specialist-topograf në Sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë” pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Me shkresën Nr. 228 Prot., datë 24.02.2014, “Emërim dhe transferime në detyrë”, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë” në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë, duke theksuar se marrëdhënia e punës dhe efektet financiare të tij fillojnë në datë 06.03.2014.
2. Punonjësi ***** ka filluar punë për herë të parë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me shkresën Nr 381 Prot., datë 18.04.2011, “Emërim në detyrë” në pozicionin “Specialist në Sektorin e Vendburimeve Metalore në Drejtorinë e Burimeve Minerale”. Më pas, është emëruar “Specialist në sektorin e Laboratorit të vetive fiziko-mekanike” në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, pozicion të cilin e ka mbajtur deri kur me shkresën Nr. 228 Prot., datë 24.02.2014, “Emërim dhe transferime në detyrë”, ***** emërohet Përgjegjës i Sektorit të Përpunimit të të Dhënave në Drejtorinë e

Gjeoinformatizimit. Marrëdhënia e punës për këtë punonjës në këtë pozicion ka filluar efektivisht më datë 6 mars 2014.

Nga hetimi i fakteve dhe rrethanave të dala rishtas, vërej se, për periudhën kohore ndërmjet aktit të emërimit dhe fillimit të efekteve financiare, punonjësit ***** dhe ***** kanë qenë në punë, por nuk janë paguar për shkak se kjo periudhë ka shërbyer për realizimin e procesit të dorëzimit dhe marrjes së detyrës, siç përcaktohet në pikën 51 të Kreut VII të VKM Nr. 171, datë 26.03.2014, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*, në të cilën parashikohet se: *“Dorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar bëhet, si rregull, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të lirimt. Në raste të veçanta, me urdhër të eprorit direkt, ky afat mund të zgjatet edhe me 5 (pesë) ditë të tjera.”*.

Për më tepër, nga listëpagesa dhe listëprezenca e muajit mars 2014 rezulton se për të njëjtën periudhë, pra, nga data 24.02.2014 (data e daljes së aktit të emërimit për këta punonjës) deri më datën 06.03.2014 (data e fillimit të efekteve financiare), për të njëjtat pozicione pune, janë paguar personat që i mbanin më parë këto pozicione, për shkak se ishin duke realizuar procesin e dorëzimit të detyrës përkatësisht tek punonjësit ***** dhe ***** , duke evituar në këtë mënyrë pagesën e dy personave për të njëjtin pozicion pune.

E parë në këtë kontekst, konstatoj se, në rastin konkret, periudha tranzitore e dorëzimit dhe marrjes së detyrave nuk duhet të penalizojë dhe të bëhet shkak për të përjashtuar këta punonjës nga mundësia që ofron neni 67 i Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*.

Në lidhje me dy punonjësit e tjerë, ***** dhe ***** , konstatoj sa vijon:

1. Punonjësja ***** ka filluar punë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar me aktin e emërimit Nr. 234 Prot., datë 24.02.2014, në pozicionin *“Specialiste në Sektorin e Dixhitalizimit në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit”*, duke përcaktuar se marrëdhënia financiare fillon në datë 01.04.2014.
2. Punonjësi ***** ka filluar punë pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar më 1 shtator 2008 në pozicion specialisti. Me shkresën Nr. 234 Prot., datë 24.02.2014, *“Emërime dhe Transferime në detyrë”*, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, është larguar nga pozicioni *“Specialist në Sektorin e Hapësirës Bregdetare”* në Drejtorinë e Gjeologjisë dhe është emëruar *“Përgjegjës i Sektorit të Arkivit Qendror të Gjeologjisë”* në Drejtorinë e Programim-Zhvillimit, duke theksuar se marrëdhënia e punës dhe ajo financiare në këtë pozicion fillojnë me paraqitjen në punë në datë 1 prill 2014.

Sa më sipër, vlerësoj se:

1. Pretendimi i punonjësës ***** se pavarësisht që paga në pozicionin e Specialistit në Sektorin e Dixhitalizimit ka filluar në datën 01.04.2014, detyrën e ka marrë në datën 24.02.2014 nuk qëndron, pasi fakti që në aktin e emërimit apo transferimit është shënuar një datë e mëvonshme për fillimin e efekteve financiare do të thotë se urdhërdhënësi ka shprehur vullnetin që kjo marrëdhënie pune të bëhet efektive në momentin e lidhjes së marrëdhënieve financiare dhe jo në momentin e daljes së aktit.

Pretendimi i ngritur nga ana e tyre se kohëzgjatja e marrjes së detyrës në dorëzim nga data 24.02.2014 deri më 31.03.2014, në rastin e punonjësës ***** dhe nga data 24.02.2014 deri më 01.04.2014 në rastin e punonjësit ***** është tërësisht e justifikueshme për shkak të veçorive të detyrës individuale në rastin e parë dhe për shkak të volumit të madh të dokumentacionit që përmbajnë dosjet e arkivit në rastin e dytë, nuk qëndron. Pika 51 e Kreut VII të VKM Nr. 171, datë 26.03.2014, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”*, ka përcaktuar në mënyrë taksative se: *“Dorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar bëhet, si rregull, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të lirim. Në raste të veçanta, me urdhër të eprorit direkt, ky afat mund të zgjatet edhe me 5 (pesë) ditë të tjera.”*. Nga analiza e kësaj dispozite konstatohet se normalisht dorëzimi i detyrës bëhet brenda 5 ditëve, duke nënkuptuar që mund të ketë edhe përjashtime *“në raste të veçanta”*, pasi mund të ketë raste objektive të cilat kërkojnë më shumë se 5 ditë. Në këto raste, me urdhër të eprorit direkt, ky afat mund të zgjatet edhe 5 ditë të tjera, por jo më shumë. Në rastin konkret, afati i dorëzimit të detyrës i tejkalon përcaktimet e sanksionuara në këtë VKM. Parimi i ligjshmërisë dhe i barazisë i sanksionuar si në Kodin e Procedurave Administrative, ashtu edhe në Rregulloren *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, kërkon që:

- vendimmarrja e tij të jetë në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore;
- për rastet objektivisht të njëjta, trajtimi duhet të jetë i njëjtë.

Në rastin konkret, mosrespektimi i kësaj dispozite dhe revokimi i pikave 1 dhe 3 të Vendimit nr. 23, datë 12.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, do të përbënte devijim nga aplikimi i standardeve të njëjta të drejtësisë, për të cilat kërkuesit pretendojnë se nuk janë zbatuar nga Komisioneri.

Në këto kushte vlerësoj se Vendimi Nr. 23, datë 12.03.2015, duhet ndryshuar duke u vendosur revokimi i pjesshëm i tij, sipas dispozitivit të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, pika 1, të Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe nenet 121 e vijues, të Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*,

V E N D O S A:

1. Të revokoj pikat 4 dhe 6 të Vendimit Nr. 23, datë 12.03.2015.
2. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të lërë në fuqi aktet e deklarimit të statusit të nëpunësit civil Nr. 1191/59 Prot., datë 14.08.2014 dhe Nr. 1191/86 Prot., datë 14.08.2014, respektivisht për punonjësit e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ***** dhe ***** , duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme administrative.

3. Në rastet kur konstatohet se pozicionet që këta punonjës mbanin në momentin e nxjerrjes së aktit të deklarimit të statusit të punësimit nuk figurojnë më si pozicione të lira, Departamenti i Administratës Publike, në bashkëpunim me Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative me qëllim sistemimin e punonjësve të mësipërm në pozicionet e lira të punës, pranë këtij institucioni.
4. Të mos pranoj kërkesat e punonjësve ***** dhe ***** .
5. Detyrat e përmendura në pjesën urdhëruese të këtij vendimi duhet të përmbushen brenda një afati prej **30 ditësh** nga marrja dijeni e këtij vendimi.
6. Në përfundim të këtij afati, Departamenti i Administratës Publike dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar duhet të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil lidhur me mënyrën e zbatimit dhe përfundimin e detyrave të lëna.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA